## MONITORIMI TEMATIK KOMBETAR 2015

# VLERËSIMI I AFATEVE NË SHQYRTIMIN GJYQESOR ADMINISTRATIV DHE DOREZIMIN E VENDIMEVE

# 2015




INFOÇIP
Qendra për Çështjet e Informimit Publik

FONDACIONI
SHOQËRIA
E HAPUR
PËR SHQIPËRINË

# VLERËSIMI I AFATEVE LIGJORE NË SHQYRTIMIN GJYQESOR ADMINISTRATIV DHE DOREZIMIN E VENDIMEVE

## VITI 2015

**MONITORIMI TEMATIK KOMBËTAR**
**EDICIONI I PARE**

*Botim nga*
**Qendra për Çështje të Informimit Publik**
**INFOÇIP**

Tiranë, 5 Qershor 2016

Rr "Todi Shkurti",P. 4, H. 21 Ap.34, Tiranë ALBANIA E-mail: qendra@infocipl.org Ëeb sites: ëëë.inforcip.org

**Botim nga Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOÇIP**
© copyright: Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOÇIP,
10 Qershor, 2016

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Materiali që përmban ky publikim mundet vetëm të citohet me kusht që të njihet autorësia e tij përmes referimit të plotë të atributeve (© copyright, data e botimit, shtëpia botuese, autorët, ISBN, etj).
Një kopje e publikimit që përmban materialin e rishtypur/referuar duhet t'i dërgohet INFOÇIP.
Çdo përdorim i metodës, të dhënave teorike apo gjetjeve sasiore në këtë studim, për qëllime komerciale ose jo-komerciale nga të tretë është i ndaluar dhe përbën objekt për ndjekje/penalizim ligjor.

**Drejtor i research-it & autor i metodës:**
Gerti Shella

**Monitorues dhe hedhje të dhënash**
E.Doda
G. Sinani
D. Selmani
I. Biçaku

**Design Layout**
Altin Aliaj

*Imazhi në Korpertinë:* **Në pritje të zbardhjes së vendimit**

Botuar nga Qendra për Çështjet e Informimit Publik
ISBN: 978-9928-4372-0-4

**U realizua në kuadër të projektit:**
**"Vonesat në arsyetimin dhe shpalljen e vendimeve gjyqesore-2"**

FONDACIONI SHOQËRIA E HAPUR PËR SHQIPËRINË

**Ky projekt është mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) në kuadër të programit Shteti i së Drejtës**
**Mendimet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të OSFA-s.**

# PERMBATJA

**KAPITULLI 1** - ***OBJEKTI, LEGJITIMITETI*** 7

MBI OBJEKTIVAT E STUDIMIT 9

BAZA LIGJORE PËR ARSYETIMIN DHE DORËZIMIN E VENDIMEVE 15

**KAPITULLI 2** - ***GJETJET E MONITORIMIT*** 21

GJETJET E MONITORIMIT, GJYKATA E APELIT ADMINISTRATIV 23

SHKURT MBI GJYKATAT ADMINISTRATIVE TE SHKALLES SE PARE 31

GJETJET E MONITORIMIT, GJYKATA ADMINISTRATIVE, TIRANË 33

GJETJET E MONITORIMIT, GJYKATA ADMINISTRATIVE, SHKODËR 39

GJETJET E MONITORIMIT, GJYKATA ADMINISTRATIVE, GJIROKASTËR 43

GJETJET E MONITORIMIT, GJYKATA ADMINISTRATIVE, KORÇË 47

GJETJET E MONITORIMIT, GJYKATA ADMINISTRATIVE, VLORË 51

GJETJET E MONITORIMIT, GJYKATA ADMINISTRATIVE, DURRËS 55

PËRMBLEDHJE E GJETJEVE 59

METODOLOGJIA 63

**KAPITULLI 3** - ***TRYEZA KOMBETARE E NIVELIT TE LARTE*** 67

KONKULZIONET E TYEZES 69

REKOMANDIMET 74

# LISTA E SHKURTIMEVE

**LGJA** – Ligji Per Gjykatat Administrative (shkurtimisht)
**GJEDNJ** – Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut
**KiE** – Këshilli i Europës
**GJK** – Gjykata Kushtetuese
**GJL** – Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë
**GJAA** – Gjykata Administrative e Apelit
**GJASHP** – Gjykata Administrative e Shkallës së Parë
**VGJK** – Vendim i Gjykatës Kushtetuese
**VUGJL** – Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë
**VKB** – Vendim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë
**KM** – Këshilli i Ministrave
**VKM** – Vendim i Këshillit të Ministrave
**MD** – Ministria e Drejtësisë
**KAGJL** – Kolegji Administrativ në Gjykatën e Lartë
**QBZ** – Qendra e Botimeve Zyrtare
**KPrC** – Kodi i Procedurës Civile (në disa raste: **KPC**)
**KPrP** – Kodi i Procedurës Penale (në disa raste: **KPP**)
**RSH** – Republika e Shqipërisë
**INFOÇIP** – Qendra për Çështje të Informimit Publik

# FALENDERIME

*Qendra për Çështjet e Informimit Publik, INFOÇIP, falenderon kryetarët e gjykatave që targetoi ky vlerësim tematik, të cilët mirëpritën ekipet monitoruese dhe lejuan akses në të dhënat që administron gjykata, posaçërisht ato që lidhen me kohën e shqyrtimit dhe dorëzimin e vendimeve.*

*Një falenderim i veçantë shkon për kryetarin e Gjykatës Administrative të Apelit, Z. Kastriot Selita si dhe për kryetarin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, Z. Eriol Roshi, të cilët mirëpritën dhe akomoduan për të dytin vit rradhazi ekipet e INFOÇIP për të përmbushur detyrat e ngarkuara. Bashkëpunimi i ofruar prej tyre ka qenë mjaft cilësor dhe i sinqertë.*

*INFOCIP falenderon ekspertët e përfshirë në këtë studim kombëtar, për të gjtha këshillat dhe sugjerimet teknike që ofruan. Në mënyrë të veçantë INFOÇIP falenderon gjyqtaren Manjola Bejeleri për konsultimin e vazhdueshmëm dhe profesional që i ka ofruar ekipit të INFOCIP të përfshirë në këtë studim.*

*INFOÇIP falenderon edhe kancelarët dhe krye-sekretaret e gjykatave që targetoi ky studim, për gjithë ndihmën dhe bashkëpunimin e ofruar në mbledhjen e të dhënave. Personeli i sekretarive gjyqësore u tregua gjithmonë i disponueshëm per te siguruar te dhenat e nevojshme, pavarësisht presionit të kohës dhe ngarkesës së punëve të përditshme.*

*Një falenderim i fundit, por i pari për nga rëndësia, shkon për Fondacionin "Shoqëria e Hapur për Shqipërinë" (SOROS) që mbështeti realizimin e këtij monitorimi unik në llojin e vet, i cili cakton nje gur themeli ne vleresimet e pavarura qe i behen nivelit te zbatimit te ligjit në sistemin te drejtesise administrative në Republiken e Shqipërisë.*

# KAPITULLI I

## OBJEKTI, LEGJITIMITETI

*1. Vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara.*
*2. Gjykata e Lartë duhet t'i botojë vendimet e saj, si dhe mendimet e pakicës.*
*3. Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.*

**Neni 142. Kushtetuta e Shqipërisë**

# MBI OBJEKTIVAT DHE RISITË E VLERËSIMIT TEMATIK, 2015

NGA **GERTI SHELLA**
*DREJTOR I STUDIMIT*

Vlerësimi kombëtar tematik për afatet e shqyrtimit gjyqësor dhe ato të dorëzimit të vendimeve në Gjykatave Administrative në RSH realizohet për herë të parë në absolut. Ai ka shtrirje të plotë kombetare duke vendosur kështu një gur themeli në fushën e monitorimeve tematike në sistemin gjyqësor administrativ.

Studimi sjell risi si në konceptim ashtu edhe në mënyrën e realizimit. Medodologjia e përdorur është unike, e është dizenjuar nga INFOCIP për të ofruar efikasitet maksimal në kontrastimin e afateve ligjore me gjetjet konkrete të përftuara nga monitorimi i regjistrave të gjykatave. Është fakt se ligji 49/2012 *"Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"* cakton afate ekplicite sa i takon shqyrtimit gjyqësor dhe dorëzimit të vendimeve, duke dhënë mundësi konkrete për të realizuar matje të sakta sa i takon respektimit (tejkalimit) të këtyre afateve.

Kur flasim për drejtësinë administrative, afatet janë njëkohësisht mjet dhe qëllim për plotësimin tiparit themelor që karakterizon këtë lloj drejtësie: gjykimi i shpejtë dhe pa zvarritje. Respektimi i termave kohore është kusht për të interpretuar drejt qëllimin e ligjvenësit për një drejtësi pa vonesa që garanton të drejtat e subjekteve (individuale ose juridike) ndaj arbitraritetit me të cilin mund t'i përballë administrata shtetërore. Jashtë afateve nuk ka drejtësi administrative efektive. Afatet e shpejta në gjykim kanë qenë në thelb nevoja që diktoi miratimin me ligj organik të këtij sistem special gjykatash në vitin 2012.

Që në vitin 2014, INFOCIP pilotoi sistemin e vet të vlerësimit të aftateve në vetëm dy gjykata, konkretisht gjykata administrative e shkallës së parë Tiranë dhe Gjykata Admisnitrative e Apelit (me seli në Tiranë). Vlerësimi i 2014-ës u limitua vetëm në monitorimin e afateve të dorëzimit të vendimeve në sekretarinë e gjykatës. Ligji 49/2012 ofron në fakt një avantazh të rëndësishmë për të kontrastuar të dhënat në këtë drejtim, sa kohë që cakton afatin fiks prej 7 ditësh për të përmbyllur këtë fazë finale të gjykimit administrativ. Ndërhyrja e parë, jo vetëm që ishte e dobishme për konstatimin e problemeve, por ndihmoi edhe në konsolidimin e plotë të qasjes metodoligjike. Ajo krijoi konfidencë absolute në kapacitetet procesuese të INFOCIP për përpunimin e të dhënave, të cilat kapërcenin rendin e mbi 30000 vendimesh gjyqësore. Pilotimi krijoi gjithashtu edhe të parën baze-line mbi të cilën mund të indikohej progresi.

Ndërkohë, analiza DAV që u konceptua nga INFOCIP që në vitin 2014 për krahasimin e treguesve për sistemin e gjykatave të zakonshme, e ri-konfiguruar sivjet për vlerësimin e gjykatave administrative, përfaqëson një instrument autentik për të matur progresin përmes vlerësimeve tematike me target të përcaktuar në sistemet gjyqësore, pavarësiht tipareve të tyre tashmë.

Vlerësimi tematik i vitit 2015 ka zgjeruar fokusin e tij, duke përfshirë për herë të parë matjen e afateve te shqyrtimit gjyqësor. Kjo është gjithashtu risi absolute, jo vetëm në kudër të vlerësimeve të INFOÇIP, por më gjerë edhe në nivel kombëtar. Vlerësimi i afateve të shqyrtimit gjyqësor është aplikuar ndaj të gjitha gjykatave administrative në RSH,

çka përbën risi në vetvete. Për herë të parë tashmë ekzistojnë mundësi reale për të përllogaritur vonesat e shqyrtimit gjyqësor administrativ. Në përgjithësi, sipas jurisprudencës së GJEDNJ, përllogaritet nga moment i depozitimit të kërkesë padisë dhe deri në dorëzimin e vendimit përfundimtar në sekretarinë e gjykatës.

Qëllimi i ligjvësit, i reflektuar qartësisht në ligjin organik 49/2012, ka qenë që shqyrtimi gjyqësor administrativ të mbyllet jo më vonë se 30 ditë, kurse vendimi përfundimtar, bashke me dosjen gjyqësore të dorëzohet në sekretari jo më vonë se 7 ditë (37 ditë në total, si për shkallën e parë ashtu edhe apelin).

Studimi i realizuar nga INFOCIP i kontraston afatet ligjore me realitetet e konstatuara në çdo gjykatë administrative. Realitet në këtë rast është praktika e përditshme sikurse ajo fiksohet apo dokumentohet në regjistrat e vetë gjykatave, nga personeli i tyre përgjegjës. Gjetjet dhe krahasimet (aty ku është e mundur), orontojnë në këtë pikë edhe diskutimin institucional dhe legjislativ për gjetjen e zgjidhjeve, me synim përmirësimin e situatës.

INFOÇIP, me ekpertizën dhe përvojën e gjerë të krijuar tashmë në monitorimet dhe vlerësimet tematike në sistemin gjyqësor, synon t'i vijë në ndihmë së pari trupës gjyqësore të GJA, duke i dhënë mundësi kësaj të fundit të njihet me rezultatet e këti vlerësimi dhe të nxjerrë konkluzonet e veta. Ky mund të kosiderohet një "auditim" mirëfilli i punës së tyre, i realizuar nga aktorë të specializuar jashtë sistemit gjyqësor. Të dhënat janë përpunar në mënyrë të tillë që të mundësojnë përmes atributeve të vendimit edhe identifikim e emrit korrespondues të gjyqtarit apo trupës gjyqësore që e ka dhënë atë. Ky ushtrim mund të realizohet fare mirë nga cilido i interesuar përmes rakordimit të dhënave të INFOÇIP me arkivat e vendimeve gjyqësor që administrohen nga gjykatat e targetuara. Kjo është një përmasë e re vlerësimi, që kapërcen hermetizmin që karakterizon në përgjithësi organet shtetërore që kanë për detyrë inspektimin e performancës profesionale të trupës gjyqësore.

Po ashtu, një tjetër avantazh i rëndësishëm i metodës dhe qasjes vlerësuese të INFOÇIP është konktrolli abstrakt, në kuptimin jo-

nominal, i vonesave në shqyrtim gjyqësor të çështjeve administrative dhe dorëzimin e vendimeve gjyqësore. Kjo qasje e diferencon atë nga metodat verifikuese që përdoren nga inspektoriatet e KLD dhe të MD, të cilat vihen në lëvizje si rregull pas marrjes së sinjaleve për parregullsi.

Po ashtu, vlerësimi tematik i realizuar nga INFOCIP direfencon thelbësish nga monitorimet me "kampionim" të organizatave ndërkombëtare. Metoda e INFOCIP nuk "filtron 10 apo 20 çështje për të bërë më pas përgjithësime. Përkundrazi, INFOCIP analizon një për një, në varg të pandërprerë indeksues vendimet gjyqësore, ne rendin 200-2000 vendime, për një periudhë kohore fikse (4 muaj ose 6 muaj) duke garantuar koherencë dhe mbi të gjithë efekt përgjithësues thuajse absolut.

KLD dhe të MD janë të lutur që të disponojnë të dhënat që bëhen publike në këtë raport dhe, pasi t'i verifikojnë dhe konsolidojnë ato, të ndërmarrin veprimet e nevojshme për adresimine problematikës së identifikuar. INFOÇIP shpehet e gatshme t'u vendosë atyre në dispozicion të gjithë bazën materiale që ka në dispozicion për një rakordim të plotë të çdo verifikimi nga ana e tyre sit ë gjetjeve tona, ashtu edhe të dhënave kritike për trupën gjyqësore. Thënë kjo, INFOÇIP garanton paanshmëri dhe objektivitet në vlerësimin e afateve të dorëzimit të vendimeve gjyqësore. Gjetjet e paraqitura në këtë raport vlerësimi janë të hapura për t'u verifikuar nga cilido aktor i interesuar.

E fundit, por jo për nga rëndësia është fakti i aplikimi për herë të parë si mjet për marrjen e informacionit në gjykata të ligjit të ri 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit". Të gjitha të dhënat për vitin 2015 të mbledhura në 7 gjykatat administrative, u morën përmes depozitimit të kërkesës për informim. Ky shënon një moment kulmor të përdorimit të instrumentit në sistemin e gjykatave administrative të RSH. Vlen të theksohet se secila gjykata e adresuar në këtë mënyrë, ka dorëzuar informacionin e kërkuar brenda afatit 10 ditor që parashikon ligji. Kërkesa për informacion u depozitua konform protokollit ligjor, duke përdorur si formatin elektronik ashtu edhe kërkesën në letër.

Në total, përmes instrumentit të drejtës për informim u administruan të dhëna për mbi 5000 vendime gjyqësore administrative, që i takojnë gjysmës së dytë të vitit 2015. Për çdo vendim, janë dokumentuar (mbledhur si të dhëna) atributet e tij (nr. dhe datë), numër rregjistri dhe datë regjistrimi, data e dorëzimit, data e nisjes së procesit, palët në proces, vendi i gjykimit (dhomë këshillimi), mënyra e zgjidhjes, relatori, kryesuesi dhe/ose anëtarët e trupit gjykues. Në total janë rreth 55000 të dhëna nga regjistrat zyrtarë të gjithë gjykatave administrative në vend, të mbledhura përmes ligjit 119/2014.

Kjo përfaqëson edhe shifrën më të lartë të të dhënave të mbledhura ndonjëherë nga sistemi igjykatave në RSH përmes apikimit të drejtës për informim. Padyshim që ky është nëj gur tjetër themeli në përpjekjet e INFOÇIP për të promovuar mekanizmin ligjor të drejtës së informimit, këtë herë në gjykata. Jo më larg se një muaj më parë, INFOCIP bëri edhe vlerësimin e plotë të implementimit të kërksave të ligjit 119/2014 në të gjthë sistemin e bashkive të RSH, sikurse ato u rikonfiguruan pas Reformës Administrative Territoriale. Në vlerësimin modest të INFOCIP, në të dyja rastet provohet qartësisht fuqia e lartë procesues, metodologjitë e avancuara si dhe kapacitete për të ndërmarrë vlerësime të dhënash në përmasa të panjohura më parë në sektorin e  shoqërisë civile.

Shpresojmë që analizat dhe vlerësimet e këtij studimi voluminoz, të realizuar nga INFOÇIP në bashkëpunim me ekspertë dhe profesionistë të njohur të sistemit gjyqësor, të shërbejnë për orientimin më të mirë të përpjekjeve të tyre në përmirësimin e sistemit gjyqësor administrativ. Ky i fundit ka nevojë të përkrahet dhe të ndihmohet me burime njerëzore, financiare dhe infrastrukturore për të perfrormuar me cilësi dhe sigurisht në afat, **misionin për një drejtësi pa vonesa**. INFOÇIP shpreson që gjetjet e këtij monitorimit të meritojnë vëmendjen e medias, por edhe të aktorëve të shoqërisë civile dhe komunitetit donator, që punojnë për rritjen e efiçiencës së gjyqësorit në Shqipëri.

**Tiranë, 5 Qershor, 2016**

# LEGJITIMITETI I MONITORIMIT, 2015
## BAZA LIGJORE PER AFATET E SHQYRTIMIN GJYQESOR & DOREZIMI I VENDIMEVE ADMINISTRATIVE

### I. MBI GJYKATAT ADMINISTRATIVE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE

Drejtësia administrative, si degë më vete e sistemit të gjykatave në Shqipëri, zë fill me miratimin e ligjit nr. 49/2012 *"Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"*. Ky ligj është ndër prekursorët më të rëndësishmë të Reformës në Drejtësi. Në relacionin shoqërues të projekt-aktit për kuvendin thuhej shprehimisht që në paragrafin e parë: *Qëllimi i këtij ligji është reformimi i kuadrit të përgjithshëm ligjor administrativ në Shqipëri në kuadër të reformës në drejtësi.*

Krijimi i Gjykatës Administrative u motivua nga nevoja për garantimin e mbrojtjes efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshme të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe *brenda afateve të shpejta e të arsyeshme.* Afatet janë mjeti dhe qëllimi për garantimin optimal të sigurisë juridike në kontekstin e këtij ligji.

Në ndryshim nga Kodi i Procedurave Administrative në RSH, ligji 49/2012 garanton mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të personave nëpërmjet detyrimit që i vihet organeve publike të provojnë ligjshmërinë e formës dhe të përmbajtjes të veprimit administrativ të nxjerrë prej tyre (*barra e provës i ngarkohet organeve publike*).

Shqyrtimi ligjor i vendimeve administrative nga gjykata të pavarura është një parim demokratik i pranishëm në praktikat kryesore evropiane dhe një kontribut i rëndësishëm për të siguruar rendin, veçanërisht **për të mbrojtur të drejtat individuale përballë administrates publike (shtetërore).**

Drejtësia administrative luan rol vendimtar edhe në zhvillimin ekonomik

të një vendi. Pothuajse të gjitha vendimet për investime, projekte për infrastrukturën etj., duhet të kalojnë përmes një procesi licencimi, i cili mund të bëhet object shqyrtimi nga gjykatat administrative. Një sistem efikas i gjykatave administrative ndihmon në shtimin e transparencën e vendimeve administrative dhe mund të luajnë një rol të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit.

Kontrolli gjyqësor i veprimeve publike administrative nga një gjyqësor administrativ që funksionon mirë rrit besimin e qytetarëve në institucionet shtetërore. Ndër kompetencat e gjykatave administrative është edhe kontrolli gjyqësor ndaj akteve të qeverisë dhe ekzekutivit në tërësi.

***

Njësoj si për gjykatat e zakonshme, edhe ato administrative organizohen në tre shkallë. Gjykata kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative janë gjykatat administrative të shkallës së parë, Gjykata Administrative e Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

Kompetencat tokësore, selia qendrore, si dhe numri i gjyqtarëve të gjykatave administrative të shkallës së parë dhe të Gjykatës Administrative të Apelit caktohen me dekret të Presidentit të Republikës, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë. Ministri i Drejtësisë bën propozimet, pasi të ketë marrë më parë mendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Aktualisht në Shqipëri funksionojnë 6 gjykata administrative të shkallës së pare, të vendosura respektivisht në Durrës, Gjirokastër, Korçë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë. Ndërkohë, ka vetëm një Gjykatë Administrative Apeli për të gjithë R.SH dhe kjo është e vendosur në Tiranë.

Gjykata Administrative e Apelit ka patur fillimisht 7 gjyqtarë, deri në janar 2016, kur numri i trupës gjyqësore u rrit në 13. Po ashtu edhe selia e kësaj gjykate është ndryshuar.

Për shkak të kritereve ligjore, trupa gjyqësore në nivel të gjykatave administrative të shkallës së parë ka mbetur në një pjesë të mirë e paplotosuar, edhe pse kanë kaluar rrth 4 vjet nga miratimi i ligjit 49/2012.

Në vlerësimet e INFOCIP, edhe sikur trupa gjyqësore të ishte e plotësuar 100%, përsëri ky do të ishte sot një numër i ulët gjyqtarësh krahasuar me ngarkesën në rritje të çështjeve që shqyrtohen nga ky sistem gjykatash.

***

Një ndër tiparet kryesore të gjykimit administrativ është shpejtësia me të cilën ai duhet të realizohet. Limitet kohore të shqyrtimit gjyqësor të veprimeve administrative, duhet të fillojnë kur individi i prekur njoftohet për veprimin administrativ dhe informohet saktësisht për të drejtat e tij/saj

në lidhje me ankimin ose apelin.

Ligji gjithashtu bën përcaktime të sakta mbi afatet të cilat duhet të respoktehen nga palët ndërgjyqëse për depozitimin e kërkesë-padisë. Ligji përcakton një afat prej jo më shumë se 10 ditësh nga dita e paraqitjes së padisë për të nxjerrë urdhërin për caktimin e seancës gjyqësore.

Ligj përcakton afate të qarta edhe për kryerjen e një sërë veprimesh përgatitore nga gjyqtari kryesues, veprime të cilat dokumentohen në procesverbalin e veprimeve përgatitore, që përpilohet nga sekretari gjyqësor dhe nënshkruhet edhe nga gjyqtari kryesues.

Ligji cakton një afat të përgjithshëm prej 10 ditësh për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës, dhe vetëm në raste të veçanta dhe të justifikuara lejon përcaktimin e një afati më të gjatë. Në pjesën urdhëruese të vendimit përfundimtar gjykata duhet të përcaktojë afatin dhe mënyrën e ekzekutimit të vendimit përkatës.

Për shkak se studimi i INFOCIP përqëndrohet posacërisht në afatet e shqyrtimit gjyqësor dhe të dorëzimit të vendimeve, në këtë trajtesë do të ndalemi posacërisht ne detajimin e këtyre të fundit, dhe jo të të gjithë sistemit të afateve që përmban ligji 49/2012 *"Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"*.

## II. AFATET PROCEDURALE PËR SHQYRTIMIN GJYQËSOR ADMINISTRATIV

Sa i takon kohës brenda së cilës duhet të realizohet dhe përmbyllet shqyrtimi gjyqësor, ligji ka përcaktuar afate vetëm (eksplicite) strikte për shkallën e dytë dhe shkallën e tretë të gjykimit.

Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen **brenda 30 ditëve** nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur. Gjykata Administrative e Apelit dërgon dosjen në gjykatën administrative të shkallës së parë jo më vonë se 3 ditë pas kryerjes së njoftimit të vendimit të palëve (neni 48 pika 2 dhe 3)

Sa i takon dërgimit të rekursit në Gjykatën e Lartë, neni 60 i ligjit 49/2012 bën gjithashtu pëcaktime të qarta. Gjykata administrative e shkallës së parë dërgon rekursin, së bashku me aktet që i bashkëlidhen atij, vendimin e gjyqtarit për pranimin e rekursit, aktet e komunikimit të rekursit, kundër-rekursin, si dhe dosjen e gjykimit në Gjykatën e Lartë, brenda 10 ditëve nga data e përfundimit të komunikimeve. Gjykata e Lartë

shqyrton çështjen **brenda 90 ditëve** nga data e ardhjes së rekursit dhe akteve bashkëlidhur prej gjykatës ku është depozituar rekursi.

Çuditërisht, ligji nuk përshkruan e as vendos afat për shqyrtimin gjyqësor administrativ në shkallë të parë. Kjo është komentuar edhe më herë nga INFOCIP si një anomali e ligjit të ri. Jo vetëm që kjo qasje është përjashtim nga rregulli të cilit i nënshtrohen dy gjykatat e shkallëve më të larta, por ajo nuk reflekton as standartin e vjetër që aplikohej nga seksionet administrative të gjykave të faktit në sistemin e zakonshëm gjyqësor.

Në ndryshim nga neni 327 i K.Pr.Civile, i shfuqizuar, që përcaktonte se shqyrtimi i mosmarrëveshjes duhet të përfundojë brenda 30 ditëve nga dita e regjistrimit në gjykatë, LGjA nuk parashikon afate për gjykimin e mosmarrëveshjeve në gjykatat e shkallës së parë. Në interpretimet zyrtare që janë dhënë për këtë anomaly, pretendohet se mos-përshkrimi i një afti në ligj ka të bëjë me promovimin e parimit të zhvillimit të gjykimit brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme, që nënkupton përdorimin e afateve në raport me natyrën e veprimit që kërkohet të kryhet për të mos dëmtuar cilësinë e drejtësisë dhe sidomos të drejtën e palëve për t'u mbrojtur efektivisht. Ky shpjegim që haste edhe në dokumenta zyrtare të KLD[1], nuk përkthen as në substancë dhe as në formë qëllimin e gjthëpranuar të ligjvënësit për orientimn e gjykimit adminsitrativ drejrt afateve të shpejta dhe të përcaktuara ligjerisht.

Si rregull, një gjykatë më e lartë, për shkak të volumit të çështjeve që mbledh si për shkak të veçorive të shqyrtimit në trupë gjyqësore me më shumë se një gjyqtar, ka në dispocicion përgjithësisht afate më të zgjeruara krahasuar me një gjykatë më të ulët. Për analogji, nëse afati i shqyrtimit gjyqësor për gjykatën e apelit administrativ është caktuar në ligjin 49/2012 të jetë 30 ditë nga depozitimi i padisë, ky afat është trefish më i madh, pra 90 ditë, për shqyrtimin e çështjes nga Kolegjet Administrative të Gjykatës së Lartë. Pra ka një raport 1:3 kur kalon nga një shkallë më ulët në një shkallë më të lartë sa i takon afatit për dorëzimine vendimit.

Nëse do të aplikohej parimi i përcaktimit me analogji të një afati për gjykatat e shkallës së parë, ai do të duhet të ishte rreth 10 ditë (pra trefish më pak se afati 30-ditor i Gjykatës së Apelit). Kjo logjikë nuk është e panjohur për sistemin e gjykatave në vend. Konkretisht, Kodi i Procedurës Civile nuk ka përcaktuar një afat për Gjykatat e Apelit të sistemin e zakonshmë gjyqësor sa i takon dorëzimit të vendimeve gjyqësore përfundimtare në Sekretari;

*1 Faqe 6, STUDIMI VLERËSUES MBI NGARKESËN E PUNËS NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË APELIT (Miratuar me vendimin nr. 23, datë 04.03..2015 të KLD-së), link: http://ëëë.drejtesia.gov.al/files/userfiles/Dokumenta/Studimi_mbi_ngarkesen_ne_Gjykaten_Administrative_te_Apelit.pdf*

gjyqtarët e nxjerrin këtë afat me analogji duke krahasuar raportet analoge mes gjykatës së shkallës së parë dhe Gjykatës së Lartë....ky afat, sipas tyre eshte jo më pak se 20 ditë.

Megjithatë, nisur nga premise specifike se, ligjvënësi ka caktuar në caktuar në ligjin 49/2012 të njëjtin afat 7 ditor për dorëzimin e vendimit si për gjykatën administrative të Faktit ashtu dhe për atë të Apelit, në vlerësimin e autorëve të këtij studimi, afati për shqyrtimin e çështjes në shkallë të parë mund të përllogaritet gjithashtu (për analogji) 30 ditë. Nuk do të kishte kuptim dhe as koherencë logjike që ky afat të ishte më i madh se sa ai në dispozicion të gjykatës që qëndron një shkallë më lartë, pra Apelit Administrativ. Rrjedhimisht, në pamundësi për të kontrastuar gjetjet e studimit me një afat eksplicit të përcaktuar në ligjin 49/2012, INFOCIP do të adoptojë këtë afat "maksimalist", pra 30 ditë, për të bërë vlerësimin e këhëzgjatjes së shqyrtimit gjyqësor në gjykatat administrative të shkallës së parë.

Aktualisht, në inspektimin e veprimtarisë gjyqësore për qëllime të vlerësimit profesional dhe për qëllime të procedimit disiplinor, Inspektorati i KLD-së i referohet kritereve matëse të sistemit të vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve të përcaktuara me Vendimin e KLD-së nr. 261/2, datë 14.04.2010 "Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve". Ky Sistem përcakton si standard matës kohor për çështjet administrative në shkallë të parë afatin 1 mujor dhe për çështjet administrative në gjykatën e apelit afatin 6 mujor.

Sa më sipër është një arsye më shumë për të fiksuar afatin 30 ditor edhe në kuadër të metodologjisë që përdor INFOCIP për qëllime të këtij vlerësimi.

## III. AFATET PËR DORËZIMIN E VENDIMIT GJYQËSOR ADMINISTRATIV

Në ligjin nr.49/2012 *"Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"*, parashikohet qartësisht forma e shpalljes së vendimit dhe afatet e dorëzimit të dosjes në sekretarinë gjyqësore. **Vendimi, pavarësisht formës së gjykimit, duhet të shpallet detyrimisht i arsyetuar.**

Konkretisht, në nenin 42 të ligjit nr.49/2012 parashikohet se gjykatat administrative të shkallës së parë shpallin detyrimisht të arsyetuar vendimin gjyqësor. Brenda 7 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore. Në rastet përjashtimore dhe vetëm për shkak të pamundësisë absolute, e shtyn shpalljen e arsyetuar të vendimit deri në 5 ditë.

Edhe për Gjykatën Administrative të Apelit aplikohen të njëjtat afate si në shkallën e parë. Brenda 7 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore (*neni 55*). Edhe këtu, në raste përjashtimore dhe vetëm për shkak të pamundësisë absolute, ajo e shtyn shpalljen e arsyetuar të vendimit gjyqësor deri në 5 ditë.

Për shqyrtimin në Gjykatën e Lartë (*Kolegji Administrativ*), neni 64 ruan të njëtën koherencë sa i takon formës së shpalles: **vendimi, pavarësisht formës së gjykimit, duhet të shpallet detyrimisht i arsyetuar.**

Në raste përjashtimore dhe vetëm për shkak të pamundësisë absolute, gjykata shtyn shpalljen e arsyetuar të vendimit deri në 10 ditë. Brenda 10 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore.

Objekt vlerësimi në këtë studim janë pikërisht këhëzgjatja e shqyrtimit gjyqësor si dhe vlerësimi i vonesave në dorëzimin e vendimeve në sekretarinë e gjykatës. Ky vlerësim realizohet për herë të parë në shkallë kombëtare dhe synon të vendosë një gur themeli në monitorimet tematike të gjykimit administrativ në Shqipëri. Legjitimiteti i këtij vlerësimi buron direkt nga përcaktimet që përmban ligji nr.49/2012 *"Për organizimin dhe funksionimine Gjykatave Administrative dhegjykiminemosmarrëveshjeve administrative"* lidhur me sa më sipër.

## IV. DISPONIMI I TE DHENAVE PERMES LIGJIT PER TE DREJTEN E INFORMIMIT

Për të disponuar volumin e madh të të dhënave që nevojiteshin për një vlerësim tematik të këtyre përmasave, INFOÇIP ka përdorur mekanizmin e ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit". Ky shënon një moment kulmor të përdorimit të instrumentit në sistemin e gjykatave administrative të RSH. Vlen të theksohet se secila gjykata e adresuar në këtë mënyrë, ka dorëzuar informacionin e kërkuar brenda afatit 10 ditor që parashikon ligji. Kërkesa për informacion u depozitua konform protokollit ligjor, duke përdorur si formatin elektronik ashtu edhe kërkesën në letër. Në total, përmes instrumentit të drejtës për informim u administruan të dhëna për mbi 5000 vendime gjyqësore administrative, të dhëna gjatë gjysmës së dytë të vitit 2015. Për çdo vendim, janë mbledhur të dhëna për atributet e tij (nr. dhe datë), numër rregjistri dhe datë regjistrimi, data e dorëzimit, data e nisjes së procesit, palët në proces, vendi i gjykimit (dhomë këshillimi), mënyra e zgjidhjes, relatori, kryesuesi dhe/ose anëtarët e trupit gjykues. Në total janë rreth 55000 të dhëna nga regjistrat zyrtarë të gjithë gjykatave administrative në vend, të mbledhura përmes ligjit 119/2014.

# KAPITULLI II

## GJETJET E MONITORIMIT



# GJETJET E MONITORIMIT, 2015

## GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Gjykata Administrative e Apelit gjatë vitit 2015 e ushtroi aktivitetin e saj me një trupë gjyqësore prej 7 gjyqtarësh. Ne fillim të vitin 2016, trupa gjyqësore e Gjykatës Administrative të Apelit u rrit nga 7 në 13 gjyqtarë. Ky përbën një moment shumë të rëndësishëm jo vetëm në plotësimin e premisave bazë për mirë-funksionimin e kësaj gjykate, por edhe në raport me një ndër rekomandimet kryesore të INFOÇIP në kuadër të vlerësimit tematik për vitin 2014. Një meritë e posaçme për këtë ndryshim mjaft pozitiv shkon për Ministrin e Drejtësisë, Z. Ylli Manjani, i cili që në fillim të marrjes së detyrës dhe në vijueshmëri ka treguar një kujdes të posaçëm për eficianiecën e sistemit të gjykatave administrative. Edhe kryetari I kësaj Gjykate, Z. Kastriot Selita, ka advokuar institucionalisht në vijueshmëri nevojën për shtimin e trupës gjyqësore në këtë gjykatë.

Sipas treguesve të bërë publikë në kuadër të analizës vjetore nga vetë Gjykata Administrative e Apelit, gjatë vitit 2015 u regjistruan gjithsej 7832 çështje. Në total u gjykuan vetëm 3018. Viti 2015 filloi me një ngarkesë të mbartur nga viti 2014 prej 6481 çështjesh. Volumi i plotë i çështjeve gjatë vitit 2015 ka qenë i përbërë nga këto dy komponentë, prej të cilëve rezulton se në total numri i çështjeve gjatë vitit 2015 ka qenë 14313. Duke iu referuar numrit të çështjeve të ardhura nga gjykatat administrative të shkallës së parë gjatë vitit 2014 në raport me ato të ardhura gjatë vitit 2015 rezultoi të ishte përafërsisht i njëjtë.

Mesatarisht një gjyqtar gjatë vitit 2015 ka gjykuar 431 cështje. Në 6 mujorin e parë të vitit 2015, gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Apelit nuk u asistuan nga ndihmësit ligjor, pasi procesi i emërimit të ndihmësve ligjorë përfundoi në muajin Qershor të vitit 2015 dhe vetëm në 6 mujorin e dytë të vitit, gjyqtarët u asistuan me nga një ndihmës ligjor secili.

Ministria e Drejtësisë caktoi në organikën e kësaj gjykate një numër prej 10 ndihmësish ligjorë, për 7 gjyqtarë. Kjo ishte një arritje e rëndësishme në dy plane: së pari, u finalizua një proces i vonuar, që sipas nenit 6 duhej të ishte përmbyllur që në fillim të funksionimit të gjykatave administrative; Së dyti, emërimi i ndihmësve ligjorë, plotësoi ekipin e punës së çdo gjyqtari në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij me efiçencë.

Emërimi i ndihmësve ligjorë ka sjellë efekte pozitive, kryesisht në përgatitjen e çështjeve për gjykim si dhe në lehtësimin e gjyqtarëve për realizimin e arsyetimit të vendimeve brenda afateve ligjore.

Mbetet e nevojshme gjithsesi që çdo gjyqtarë i Gjykatës Administrative të Apelit të asistohet nga 2 ndihmës ligjorë. Kjo është një nevojë e diktuar nga volumi i punës që përballon çdo gjyqtar në këtë gjykatë.

## KOHËZGJATJA E SHQYRTIMIT GJYQËSOR , 2015

Për efekt të këtij vlerësimi u analizuan 1,233 cështje gjyqësore themeli, vendimi për të cilat është dhënë në periudhën Korrik–Dhjetor 2015 (*6 muaj*). Gjatë vitit 2015 u gjykuan gjithsej 3018 çështje administrative nga kjo gjykatë (*burimi: Analiza e Veprimtarisë së GJAA për vitin 2015*).

Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi (neni 48/2).

Rezulton se, brenda afatit prej 30 ditësh janë përfunduar vetëm 97 shqyrtime gjyqësore. Pjesa tjetër, 1136 çështje ose rreth 92% e totalit të analizuar janë përfunduar përtej këtij afati.

| NR | FASHA KOHORE | NR I VENDIMEVE |
|---|---|---|
| 1 | **0 -30 dite** | 97 |
| 2 | **mbi 30 dite** | 1136 |
| | **TOTAL** | **1233** |




Kohëzgjatja mesatare e shqyrtimit gjyqësor në këtë gjykatë rezulton të jetë 343 ditë (çështje gjyqësore themeli). Metodologjikisht kjo përfaqëson edhe mesataren vjetore për vitin kalendarik 2015 (*Shih Metodologjia*).

INFOCIP ka “filtruar” në një tabelë të posaçme edhe 30 çështjet që rezultojnë të kenë patur kohëzgjatjen më të madhe për periudhën e marrë në analizë. Kohëzgjatja në këtë rast nënkupton momentin e regjistrimit të çështjes në gjykatë deri në mometin e marrjes së vendimit përfundimtar.

| NR Vendimi | Date regjistrimi | Date Vendimi | Vonesat |
|---|---|---|---|
| 2059 | 12.02.2014 | 02.10.2015 | 597 |
| 2053 | 17.03.2014 | 01.10.2015 | 566 |
| 2418 | 16.05.2014 | 16.11.2015 | 549 |
| 2124 | 15.04.2014 | 12.10.2015 | 545 |
| 2767 | 25.06.2014 | 21.12.2015 | 544 |
| 2770 | 26.06.2014 | 21.12.2015 | 543 |
| 2774 | 26.06.2014 | 21.12.2015 | 543 |
| 2769 | 27.06.2014 | 21.12.2015 | 542 |
| 2435 | 30.05.2014 | 18.11.2015 | 537 |
| 2387 | 26.05.2014 | 12.11.2015 | 535 |
| 2377 | 28.05.2014 | 11.11.2015 | 532 |
| 2765 | 09.07.2014 | 18.12.2015 | 527 |
| 2651 | 01.07.2014 | 09.12.2015 | 526 |
| 2763 | 10.07.2014 | 18.12.2015 | 526 |
| 2699 | 09.07.2014 | 15.12.2015 | 524 |
| 2419 | 11.06.2014 | 16.11.2015 | 523 |
| 2653 | 04.07.2014 | 09.12.2015 | 523 |
| 2130 | 02.07.2014 | 14.10.2015 | 469 |
| 2157 | 04.07.2014 | 14.10.2015 | 467 |
| 2160 | 15.07.2014 | 14.10.2015 | 456 |
| 2161 | 15.07.2014 | 14.10.2015 | 456 |
| 2162 | 15.07.2014 | 14.10.2015 | 456 |
| 2158 | 16.07.2014 | 14.10.2015 | 455 |
| 2159 | 16.07.2014 | 14.10.2015 | 455 |
| 2163 | 16.07.2014 | 14.10.2015 | 455 |
| 2151 | 17.07.2014 | 14.10.2015 | 454 |
| 2153 | 17.07.2014 | 14.10.2015 | 454 |
| 2155 | 17.07.2014 | 14.10.2015 | 454 |
| 2152 | 18.07.2014 | 14.10.2015 | 453 |
| 2154 | 18.07.2014 | 14.10.2015 | 453 |

## DORËZIMI I VENDIMEVE NE SEKRETARI

Nga vlerësimi rezulton se, brenda afatit ligjor prej 7 ditësh janë dorëzuar në sekretarinë e Gjykatës Administrative te Apelit **58.56%** e totalit prej 1233 vendimesh. Pjesa tjetër prej 511 vendimesh ose **41.44%** e totalit dalin jashtë këtij afati. Periudha e analizuar është Korrik-Dhjetor 2015. Trendi që përvijohet për këtë periudhë është përfaqësues për të gjithë vitin kalendarik (*shih Metodologjinë*). Kjo do të thotë që, per vitin 2015, dispozitat e nenit 55 të ligjit 49/2012 kanë gjetur zbatim në masën **58.56%** në Gjykatën Administrative të Apelit, me seli në Tiranë.

| NR | FASHA KOHORE | NR. I VENDIMEVE |
|---|---|---|
| 1 | 0 deri 7 dite | 722 |
| 2 | mbi 7 dite | 511 |
| | TOTAL | 1,233 |




*Shprehur në %*

***Për vitin 2015, dispozitat e nenit 55 të ligjit 49/2012 kanë gjetur zbatim në masën 58.56% në Gjykatën Administrative të Apelit, me seli në Tiranë.***

Tabela më poshtë dhe grafiku ofron një pamje të afateve të dorëzimit të vendimeve sipas fashave kohore, ku më e larta është "**mbi 100**" ditë.

| PERIUDHA E VLERESIMIT: KORRIK - DHJETOR 2015 | | | |
|---|---|---|---|
| NR | FASHA KOHORE | NR. VENDIMESH | SHPREHUR NE % |
| 1 | 0 deri 7 dite | 722 | 58.56 |
| 2 | 8 deri 10 dite | 112 | 9.08 |
| 3 | 11 deri 20 dite | 195 | 15.82 |
| 4 | 21 deri 30 dite | 170 | 13.79 |
| 5 | 31 deri 40 dite | 27 | 2.19 |
| 6 | 41 deri 50 dite | 3 | 0.24 |
| 7 | 51 deri 100 dite | 4 | 0.32 |
| 8 | mbi 100 dite | - | - |
| | TOTAL | 1,233 | 100 |




***Per vitin 2015, kohëzgjatja mesatare e dorëzimit të vendimeve në sekretari është 11.4 ditë (rezultat i përgjithësuar)***

## VONESAT MË EKSTREME NË DORËZIMIN E VENDIMEVE

Viti 2015 gjithashtu e ka përballur trupën gjyqësore të Apelit Administrativ me një ngarkesë të madhe. Kjo reflektohet edhe në kapjen e afteve per dorezimin e vendimit. Vonesa me e madhe e konstatuar për 6-mujorin e dytë të 2015 është 62 ditë në dorezim. Për të njëjtën periudhë të vitit 2014, vonesa më e madhe ishte 193 ditë. Është evidente se janë bërë përpjekje nga trupa gjyqësore e Apelit Administrativ për të reduktuar vonesat gjatë vitit 2015.

Duhet theksuar se ky vlerësim tematik është fokusuar vetëm në analizimin e të dhënave që lidhem me çështjet e themelit, duke përjashtuar çdo çështje të natyrave të tjera. Nëse do të përllogariteshin fjala vjen shqyrtimet e kërkesave, treguesit do të ishim më pozitivë.

Tabela më poshtë paraqet të grupuara 30 vendimet e dorëzuara me më shumë vonesë në sekretarinë e Gjykatës Administrative të Apelit krahasuar me gjithë të tjerat e periudhës Korrik-Dhjetor 2015.

| NR VENDIMIT | DATA VENDIMIT | DATA DOREZIMIT | DIFERENCA NE DITE |
|---|---|---|---|
| 2060 | 02.10.2015 | 03.12.2015 | 62 |
| 2223 | 23.10.2015 | 22.12.2015 | 60 |
| 1918 | 21.09.2015 | 16.11.2015 | 56 |
| 2065 | 02.10.2015 | 23.11.2015 | 52 |
| 1981 | 28.09.2015 | 16.11.2015 | 49 |
| 2059 | 02.10.2015 | 18.11.2015 | 47 |
| 1980 | 28.09.2015 | 13.11.2015 | 46 |
| 2078 | 07.10.2015 | 16.11.2015 | 40 |
| 1809 | 07.09.2015 | 15.10.2015 | 38 |
| 1818 | 09.09.2015 | 15.10.2015 | 36 |
| 1563 | 26.06.2015 | 31.07.2015 | 35 |
| 1564 | 26.06.2015 | 31.07.2015 | 35 |
| 1917 | 21.09.2015 | 26.10.2015 | 35 |
| 1983 | 28.09.2015 | 02.11.2015 | 35 |
| 1991 | 28.09.2015 | 02.11.2015 | 35 |
| 2008 | 28.09.2015 | 02.11.2015 | 35 |
| 2075 | 07.10.2015 | 11.11.2015 | 35 |
| 2124 | 12.10.2015 | 16.11.2015 | 35 |
| 2165 | 14.10.2015 | 18.11.2015 | 35 |
| 2024 | 30.09.2015 | 02.11.2015 | 33 |
| 1561 | 26.06.2015 | 27.07.2015 | 31 |
| 1562 | 26.06.2015 | 27.07.2015 | 31 |
| 1566 | 29.06.2015 | 30.07.2015 | 31 |
| 1982 | 28.09.2015 | 29.10.2015 | 31 |
| 1984 | 28.09.2015 | 29.10.2015 | 31 |
| 1997 | 28.09.2015 | 29.10.2015 | 31 |
| 2003 | 28.09.2015 | 29.10.2015 | 31 |
| 2009 | 28.09.2015 | 29.10.2015 | 31 |
| 2010 | 28.09.2015 | 29.10.2015 | 31 |
| 2011 | 28.09.2015 | 29.10.2015 | 31 |
| 2013 | 28.09.2015 | 29.10.2015 | 31 |
| 2118 | 09.10.2015 | 09.11.2015 | 31 |
| 2129 | 13.10.2015 | 13.11.2015 | 31 |
| 2234 | 23.10.2015 | 23.11.2015 | 31 |

## GJA E APELIT - KRAHASIMI 2015 -2014, DOREZIMIN NE AFAT I VENDIMEVE

Siç u përmend edher më sipër, treguesi DAV (*Dorëzimi në Afat i Vendimeve*) është një indikator i posaçëm i konceptuar nga ekpertët e INFOÇIP posaçërisht për këtë lloj vlerësimi tematik. Ai pasqyrohet në pikë përqindje. DAV përllogaritet si funksion i diferencës midis së treguesve te vitit aktual dhe vitit paraardhës për vlerat që kanë të bëjnë më dorëzimin brenda afatit ligjor të vendimit të arsyetuar në Sekretari. Në këtë rast ai indeksohet si "**DAV vertikal**", për ta dalluar atë nga "**DAV horizontal**", i cili aplikohet për të indikuar diferencat kur objekt krahasimi janë gjykata të ndryshme brenda të njëjtit vit.

Në rastin e Gjykatës Administrative të Apelit, në analizë futen treguesit e dorëzimit brenda afatit 7 ditor të vendimeve të çështjeve të themelit (*pjesa e blertë e grafikut*) gjatë vitin 2014 dhe vitin 2015 .

**Shtator-Dhjetor 2014** **Shtator-Dhjetor 2015**







Sikurse sugjeron edhe grafiku *majtas* , gjatë vitit 2015 Gjykata Administrative e Apelit e ka përmirësuar treguesit dorëzimit të vendimeve brenda afatit 7-ditor me rreth 15 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2014. Ky është një progres që meriton të përgëzohet.

***Treguesi DAV shënoi një rritje prej 15 % për vitin 2015***




***Niveli i zbatimit të dispozitave e nenit 55 të ligjit 49/2012 ka shënuar rrjedhimisht përmirësim me rreth 15% gjatë vitit 2015, krahasuar me një vit më parë.***

Edhe nëse krahasohet mesatarja e ditëve që i është dashur gjykatës per të dorëzuar vendimet ne sekretari, viti 2015 paraqitet me një ndryshim ndjeshëm cilësor krahasuar me vitin 2014. Konkretisht, në vitin 2014 trupës gjyqësore të GJAA i janë dashur mesatarisht 25 ditë kalendarike për të realizuar të gjithë procesin e dorëzimit të vendimeve të themelit në sekretari (periudha Korrik-Dhjetor). Në vitin 2015, kjo mesatare rezulton të jetë vetëm 11 ditë. Kjo e dhënë flet për një përmirësim me mbi dy herë (rreth 120%) nëse krahasohen mesataret respektive të 2015-ës me 2014-ën.



# SHKURT MBI GJYKATAT ADMINISTRATIVE TE SHKALLES SE PARE

Në mbështetje të nenit 4 të . 49/2012 *"Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"*, Presidenti i Republikës nxori dekretin nr. 7818, datë 16.11.2012, të Presidentit të Republikës "Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë, të apelit dhe të gjykatave administrative, si dhe për caktimin e kompetencave tokësore, dhe selisë qendrore të gjykatave administrative". Sipas Dekretit, gjykatat administrative organizohen në 6 gjykata të shkallës së parë dhe 1 gjykatë apeli. 6 gjykatat administrative të shkallës së parë kanë kompetencë tokësore dhe seli qendrore të ushtrimit të veprimtarisë së tyre, si më poshtë vijon:

a) Gjykata administrative e shkallës së parë Tiranë, ka kompetencë tokësore në rrethet: Bulqizë, Dibër, Krujë, Laç, Mat dhe Tiranë, me seli qendrore në Tiranë;

b) GJASHP Durrës, ka kompetencë tokësore në rrethet: Elbasan, Gramsh, Librazhd, Peqin, Durrës dhe Kavajë, me seli qendrore në Durrës;

c) GJASHP Shkodër, ka kompetencë tokësore në rrethet Lezhë, Mirditë, Kukës, Has, Pukë, Malësi e Madhe, Shkodër ,Tropojë. Selia: Shkodër;

ç) GJASHP Vlorë, ka kompetencë tokësore në rrethet Berat, Skrapar, Kuçovë, Fier, Mallakastër, Lushnjë dhe Vlorë, me seli qendrore në Vlorë;

d) GJASHP Korçë, ka kompetencë tokësore në rrethet Devoll, Kolonjë, Bashkinë Leskovik, Korçë dhe Pogradec, me seli qendrore në Korçë;

dh) GJASHP Gjirokastër, ka kompetencë tokësore në rrethet Gjirokastër, Tepelenë, Përmet, Delvinë dhe Sarandë, me seli qendrore në Gjirokastër;

e) Gjykata Administrative e Apelit, me seli në Tiranë, ka kompetencë tokësore në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

## AFATET LIGJORE PER KOHËZGJATJEN E SHQYRTIMIT GJYQËSOR

Sic është shpjeguar edhe më sipër, në ndryshim nga neni 327 i K.Pr. Civile, i shfuqizuar, që përcaktonte se shqyrtimi i mosmarrëveshjes duhet të përfundojë brenda 30 ditëve nga dita e regjistrimit në gjykatë, ligji nr. 49/2012 *"Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"* nuk parashikon afate për gjykimin e mosmarrëveshjeve në gjykatat e shkallës së parë. Kjo është konsideruar edhe më parë një anomali në vlerësimet që ka realizuar INFOÇIP (është shpjeguar edhe më sipër në këtë studim tek kapitulli I "Mbi legjitimitetin e vlerësimit").

| 4-05-15 | Pavlefshmeri akti adm | 42 | 2015-01-21 | 7 dite | 7 muaj | | x | | | | | | | | | | | | |
| 09-12 | Shfuqizim AMTP | 43 | 2015-01-21 | 7 dite | 4 muaj | | x | | | | | | | | | | | | |
| 1-11 | Pavlefshmeri akti adm | 44 | 2015-01-21 | 7 dite | 2 muaj | | x | | | | | | | | | | | | |
| -05 | Korrigjim certifikate | 45 | 2014-01-21 | 7 dite | 2 muaj | | x | | | | | | | | | | | | |
| 18 | Lidhje pensioni | 53 | 2015-01-23 | 7 dite | 9 muaj | | x | | | | | | | | | | | | |
| 0 | Lidhje pensioni | 54 | 2015-01-23 | 7 dite | 2 muaj | | x | | | x | | | | | | | | | |
| | Marredhenie pune | 62 | 2015-01-26 | 7 dite | 3 muaj | | x | | | x | | | | | | | | | |
| | Palighshmeri akti | 63 | 2015-01-26 | 7 dite | 6 muaj | | x | | | | | | | | | | | | |
| | Marredhenie pune | 64 | 2015-01-26 | 5 dite | 2 muaj | | x | | | x | | | | | | | | | |
| | Marredhenie pune | 65 | 2015-01-26 | 7 dite | 3 muaj | | x | | | x | | | | | | | | | |
| | Marredhenie pune | 73 | 2015-01-27 | 7 dite | 4 muaj | | x | | | | | | | | | | | | |
| | dhje pensioni | 82 | 2015-01-28 | 7 dite | 3 muaj | | x | | | | | | | | | | | | |
| | je pensioni | 90 | 2015-01-29 | 7 dite | 3 muaj | | | | | | | | | | | | | | |
| | rim i org.publik | 91 | 2015-01-29 | 7 dite | 3 [illegible] | | | | | | | | | | | | | | |
| | edhenie pune | 92 | 2015-01-29 | | | | | | | | | | | | | | | | |

# PËRMBLEDHJE E GJETJEVE, TREGUESIT NË NIVEL KOMBËTAR

Gjatë vitit 2015 gjykatat administrative në RSH shqyrtuan një volum relativisht të lartë çështjes gjyqësore. Volumin më të madh të ngarkesës e përballoi gjykata administrative e Apelit, e vetmja në Shqipëri (me seli në Tiranë). Volum relativisht të madh përballuan edhe gjykatat e Shkodrës, Durrësit dhe Vlorës.

Pavarësisht ngarkesës, trupa gjyqësore vijoi të mbetej e paplotësuar me gjyqtarë. Vetëm në fillim të vitit 2016, falë edhe këmbënguljes së ministrit të drejtësisë, Z. Ylli Manjani, u mor vendim që trupa gjyqësore e Gjykatës Administrative të Apelit u rritej nga 7 në 13 gjyqtarë. Rritja e trupës gjyqësore së kësaj Gjykate ka qenë edhe një ndër rekomandimet e raportit të INFOCIP të publikuar vitin e kaluar.

Gjykatat administrative të rretheve gjyqësore (shkalla e parë) vijuan megjithatë të punojnë me stafe të reduktuara, një pjesë e tyre pothuajse me gjysmën e trupës gjyqësore që parashikon ligjieslacioni përkatës.

Infrastruktura e gjykatave administrative vijoi të trashëgojë mangësi të theksuara edhe në vitin 2015. Sistemet kompiuterike të dokumentimit të çështjeve gjyqësore, regjistrave etj, janë thuajse inekzistente. Me përjashtim të gjykatës së Apelit, asnjë nga gjykatat e tjera administrative në vend nuk disponon faqe interneti apo sisteme të brendshme databazash kompiuterike. Kjo ka vështirësuar punën e sekretarive të gjykatave, të cilat vijuan të përballojnë volumet e shtuara të punës me sisteme me bazë letre, të cilat janë në përdorim që nga gjysma e shekullit të kaluar.

Konstatohet se nuk ka një praktikë uniforme në mbajtjen e të dhënave gjyqësore nga sekretaritë e gjykatave. Edhe numratorët hasen në versione të ndryshme nga gjykata në gjykatë. Kjo vështirëson shumë përpunimin e të dhënave prej tyre, për qëllime të vlerësimit të ngarkesës, vonesave, etj.

Po ashtu, rezulton se të dhënat për datën e dorëzimit të vendimit si dhe për hedhjen e shortit nuk mbahen në të njëjtin regjistër themelor ku pasqyrohet numri i regjistrimit të çështjes dhe data e vendimit përkatës. Kjo praktikë duhet të rishikohet dhe të unifikohet sa më parë të jetë e mundur.

## DORËZIMI I VENDIMEVE SIPAS AFATIT LIGJOR 7-DITOR

Gjykata Administrative e Apelit e ka përmirësuar treguesit dorëzimit të vendimeve brenda afatit 7-ditor me rreth 15 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2014. Në afat u dorëzuan 59% e vendimeve për çështje themeli, krahasuar me me vetëm 46% dorëzime në afat gjatë vitit 2014.

Kohëzgjatja mesatare e dorëzimit të vendimeve në sekretarinë e kesaj gjykate gjatë 2015-ës ishte 11.4 ditë (rezultat i përgjithësuar). Në vitin 2014 trupës gjyqësore të GJAA i duheshin mesatarisht 25 ditë kalendarike për të realizuar dorëzimin e vendimeve në sekretari (periudha Korrik-Dhjetor 2014). Kjo e dhënë flet për një përmirësim me mbi dy herë (rreth 120%) nëse krahasohen mesataret respektive të 2015-ës me 2014-ën.

Sa i takon gjykatave administrative të shkallës së parë, gjatë vitit 2015, u shënua progres i ndjeshëm në respektimin e afateve ligjore për dorëzimin e vendimeve gjyqësore në sekretaritë respektive të gjykatave. Të gjithë treguesit e vlerësuar nga INFOÇIP flasin per një rritje cilësore në këtë drejtim. Rezultatin më të mirë e përfaqëson gjykata administrative e rrethit gjyqësor Shkodër, me rreth 99% të vendimeve të dorëzuar në sekretari brenda afatit 7 ditor që

RENDITJA SIPAS TREGUESVE TE DOREZIMIT NE AFAT TE VENDIMEVE



përcakton neni 42 ligji 49/2012 *"Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"*, *i ndyshuar*. Ajo ndiqet nga GJA e Gjirokastrës dhe Durrësi (95%), GJA Korçe 94%, GJA Tirane me 88% dhe në fund GJAVlorë me 37%.

| | Gjykatat | Zbatimi i ligjit |
|---|---|---|
| 1. | Shkodër | 99% |
| 2. | Durres | 96% |
| 3. | Korce | 94% |
| 4. | Gjirokaster | 95% |
| 5. | Tirane | 88% |
| 6. | Vlore | 36% |

***Në total, niveli i zbatimi të nenit 42 të ligjit 49/2012 nga të 6 gjykatat administrative të shkallës së parë të marra së bashku është 84.5% sa i takon dorëzimit në afat të vendimeve.***

## SHQYRTIMI GJYQESOR ADMINISTRATIV - AFATI 30-DITOR

Gjatë vitit 2015, shqyrtimi gjyqësor administrativ regjistroi vonesa domethënëse, megjithese u regjistrua progres krahasuar me vitin 2014. Ligji 49/2012 *"Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"* përcakton afatin 30 ditor për shqyrtimin e cështjeve nga Gjykata Administrative e Apelit, llogaritur nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi (neni 48/2).

Sa i takon Apelit Administrativ, nga vlerësimi rezultoi se, gjate 2015-ës, brenda afatit prej 30 ditësh përfunduan rreth 9% e totalit të cështjeve të themelit të analizuara nga ky studim. Kohëzgjatja mesatare e shqyrtimit gjyqësor në këtë gjykatë rezulton të jetë 343 ditë (çështje gjyqësore themeli).

Sa i takon gjykatave administrative të shkallës së parë, në ndryshim nga neni 327 i K.Pr.Civile, (*i shfuqizuar)*, që përcaktonte se shqyrtimi duhet të përfundojë brenda 30 ditëve nga regjistrimi në gjykatë, ligji nr. 49/2012 nuk parashikon afate eksplicite. Kjo përbën një mangësi të theksuar në këtë drejtim e cila rekomandohet të rishikohet në kuadër të amendimeve të mundshme që mund të pësojë ligji në të ardhmen.

INFOCIP gjithsesi aplikoi me analogji afatin 30-ditor për të bërë vlerësimin e kohë-zgjatjes së shqyrtimit gjyqësor në 6 gjykatat administrative të shkallës së parë. Kyështe edhe afati që aplikon KLD, konform përcaktimeve në Vendimin e KLD-së nr. 261/2, datë 14.04.2010 "Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve".

Pragu 30-ditor, i konsideruar si afati më i arsyeshëm për përmbylljen e shqyrtimit gjyqësor administrativ në kuadër të këtij studimi është kapur mesatarisht në vetëm 16 % të çështjeve të analizuara në shkallë vendi, duke përllogaritur të gjitha gykatat administrative të marra së bashku.

Treguesit më të favorshëm sa i takon shqyrtimit në afat sa më të shkurtër të cështjeve gjyqësore administrative e ka GJA Gjirokastër me vetëm 42 ditë mesatarisht e ndjekur me rradhë nga Vlora (64 ditë mesatarisht), Tirana (81 ditë), Korça dhe Durrësi (120 ditë), dhe Shkodra me mbi 300 ditë.

Nga vlerësimi tematik rezulton se vonesa mesatare në shqyrtimin gjyqësor administrativ në shkallë të parë për vitin 2015 është rreth 135 ditë. Me fjalë të tjera, mund të thuhet se gjatë vitit 2015 shqiptarët priten mesatarisht 135 ditë që cështja e tyre të shqyrtohej nga gjykatat administrative të shkallës së parë.

Gjatë periudhës së marrë në shqyrtim u hasën çështje, shqyrtimi i të cilave kishte zgjatur mbi 600 ditë, ndërkohë që pothuajse çdo gjykatë kishte çështje të cilat kapnin 300-ditëshin në analizën e afateve të shqyrtimit gjyqësor.

| | Gjykatat | Zbatimi i ligjit |
|---|---|---|
| 1. | Gjirokastër | 48% |
| 2. | Vlorë | 18% |
| 3. | Tiranë | 14% |
| 4. | Korçë | 9% |
| 5. | Durrës | 7% |
| 6. | Shkodër | 1% |

*RENDITJA E GJYKATAVE SIPAS VONESAVE NE SHQYRTIM*



# METODOLOGJIA

Metodologjia e hartuar nga INFOÇIP konsiston në mbledhjen sistematike të të dhënave mbi datat e dorëzimit në sekretarinë gjyqësore të vendimeve përfundimtare (dosjes gjyqësore pas mbylljes së shqyrtimit gjyqësor) dhe më pas vlerësimin e vonesave eventuale duke kontrastuar datën e vendimit me datën e rregjistrimit të cështjes dhe me datën dorëzimit të tij. Një metode e tillë analizon të gjitha vendimet një për një të regjistruara në varg indeksues të rregullt në numratorët e çështjeve gjyqësore që administrohen nga sekretaritë e gjykatave. Pra, medoda nuk proceson një numër të reduktuar çështjes (30-40) të zgjedhura me kampionim, por të gjitha vendimet gjyqësore të dorëzuar në një kohë të dhënë. Intervali minimal kohor mbi të cilën zbatohet analiza është 4 muaj (për gjykatat e faktit), kurse më i larti është një vit i plotë kalendarik (vendimet e Kolegjeve të Bashkuara të GJL). Parimi metodologjik është "sa më i madh numri i vendimeve që nxjerr një gjykatë në një njësi të dhënë kohe, aq më e vogël fasha kohore që përzgjidhet për analizim".

Për gjykatat e Apelit, fasha që analizohet është si rregull 6 muaj. Në botimet e mëpërparshme është ilistuar me shembuj konkretë se si matjet e aplikuara mbi një periudhë 12 mujore janë në fakt të nëjta me ato të realizuar mbi një periudhë 6-mujore. Kjo çon në pohimin se vlerësimi 6-mujor është në fakt një vlerësim përgjithësues për të gjithë vitin kalendarik, në rastin e Gjykatës së Apelit (si në sistemin e zakonshmëm ashtu edhe në sistemin e gjykatave administrative).

Ndërkohë, intervali më minimal që merret në analizë për gjykatat e shkallës së parë është 4 muaj, si në sistemin e zakonshmë ashtu dhe në atë administrativ. Kjo gjithashtu është një fashë kohorë shumë përfaqësuese dhe

rezultatet e gjeneruar mbi të janë ekuivalentë (marxhina e përputhshmërisë +/-2%)

Për të realizuar këtë vlerësim, që në vitin 2014 u bë identifikimi i saktë i dispozitave në korpusin e brendshëm ligjor (kode dhe ligje) të cilat përcaktojnë afatet e arsyetimit/ dorëzimit të vendimeve gjyqësore. Legjitimiteti i matjeve dhe vlerësimeve në kuadër të këtij monitorimi buron vetëm nga ligji material dhe/ose procedural.

Treguesi DAV (Dorëzimi në Afat i Vendimeve) është një indikator i posaçëm i kon- ceptuar nga INFOÇIP posaçërisht për këtë lloj vlerësimi tematik. DAV pasqyrohet në pikë përqindje. Ai është rezultat i diferencës midis vitit aktual dhe vitit paraardhës për vlerat që kanë të bëjnë më dorëzimin brenda afatit ligjor të vendimit të arsyetuar në Sekretari. DAV përdoret për të matur progresin vit pas viti, në kushtet kur krijohet një bazë fillestare me të dhëna të krahasueshme (baseline). Në këtë rast ai indeksohet si "DAV vertikal", për ta dalluar atë nga "DAV horizontal", i cili aplikohet për të indikuar diferencat kur objekt krahasimi janë gjykata të ndryshe brenda të njëjtit vit, (siç në rastin e krahasimit të gjykatave administrative të shkallës së parë). DAV është një indikator absolut. Ai nuk relativizion apo ponderon rezultatin bazuar në ngarkesën e gjyqtarëve, vështirësinë e çështjeve, apo shkaqe të tjera subjektive.

## ANALIZA KRAHASUESE E TREGUESVE TE GJYKATAVE ADMINIATRATIVE TE SHKALLES SE PARE

Pjesë e rëndësishme e këtij studimi është edhe krahasimi i treguesve mes gjykatave të të njëjtit lloj. Ky lloj vlerësimi realizohet për herë të parë në sistemin e gjykatave administrative dhe synon të ofrojë një pamje më të plotë për kuptuar më mirë dinamikat që favorizojnë (ose jo) shqyrtimin e çështjeve gjyqësore (themeli) brenda një kohë të arsyeshme si dhe dorëzimin në afat të vendimeve. Në një rast të tillë, treguesi DAV aplikohet për një vlerësim të tipit horizontal dhe jo vertikal, sikurse është ai që indikon progresin nga viti në viti në të njëjtën gjykatë.

Për të aplikuar analizën DAV horizontal, nuk ka nevojë të fiksohet një *baseline* i diferencuar kohor; mjafton që të dhënat të jenë të mbledhura brenda të njëjtës periudhë kohorë për të siguruara bazë krahasimore të njëjtë. Në thelb, analiza synon të rendisë bazuar në vlerat e treguesve

gjykatat e të njëjtit lloj të marra nën shqyrtin. Po ashtu kjo analizë ofron undësi për të bërë përgjithësime në bllok.

Sikurse është pohuar edhe më parë, shkaqet që mund të ndikojnë në vonesat e dorëzimit të vendimeve janë ngarkesat e gjyqtarëve, cilësia e asistimit të tyre, numri i ndihmësve ligjore në dispozicion, kompleksiteti i cështjeve, pa përjashtuar gjithsesi paaftësinë, dhe potencialisht nganjëherë edhe korrupsionin.

Objekt krahasimi për këtë ushtrim të posaçëm janë 6 Gjykatat Administrative të shkallës së parë, konkretisht Tiranë, Durrës, Shkoder, Vlorë, Gjirokaster, Korçë. Periudhat që do të kontrastohen mes dy gjykatave janë të njëjta, praktikisht Shtator-Dhjetor 2015.

Afati limit mbi të cilin vlerësohet shqyrtimi i një cështje gjyqësore administrative në shkallë të parë është 30 ditë kurse afati dorëzimi i një vendimi të arsyetuar në sekretarinë e gjykatës është 7 ditë.

# KAPITULLI III

## TRYEZA KOMBETARE
## E NIVELIT TE LARTE

### VLERËSIME DHE REKOMANDIME



# KONKLUZIONET E TRYEZES
## VONESAT NË SHQYRTIMIN GJYQËSOR NË GJYKATAT ADMINISTRATIVE

Në datë 15 Qershor 2016, INFOÇIP thirri dhe organizoi Tryezën e Nivelit të Lartë për të diskutuar gjetjet e Vlerësimit Tematik Kombëtar mbi afatet procedurale të gjykimit administrativ në RSH. Tryeza, e para në llojin e vet, u përcoll me një interesim të lartë nga të gjitha mediat.

***Qëllimi parësor*** i aktivitetit ishte shpallja zyrtarisht e gjetjeve të vlerësimit tematik përpara aktorëve kryesore të interesit, konkretisht kryetarëve të gjykatave administrative në të treja nivelet, Ministrisë së Drejtësisë, KLD, partnerëve ndërkombëtare që punojnë në fushën e rritjes së eficiencës së gjyqësorit në Shqipëri. Ekspozimi i gjetjeve ndaj aktorëve të tjerë të interesuar, medias dhe publikut (përmes medias) ishte pjesë e këtij qëllimi.

***Qëllimi dytësor*** për të cilën u organizua tryeza ishte diskutimi kritik i konkluzioneve të studimit me gjyqtarët dhe institucionet politikbërëse dhe ligjzbatuese. Ekspozimi i plotë i të dhënave, gjetejve si dhe shpjegimet me karakter metodologjik përpara trupës gjyqësore administrative, Ministrisë së Drejtësisë, etj., i shërbente konsolidimit të vlerësimit tematik në tërësi, por edhe të metodës së përdorur për herë të parë në shkallë kombëtare nga INFOÇIP.

***Qëllimi i tretë*** i tryezës së nivelit të lartë ishte të nxiste ndërveprimin mes aktorëve të interesuar për të hartuar një set rekomandimesh bazuar në të dhëna objektive dhe të pranuara më parë nga palët e interesuara.

Tryeza u përgatit dhe u mbajt në një kohë me rëndësi të posaçme në raport më procesin e Reformës në Drejtësi. Në datë 15 Qershor 2016, pikërisht në ditën kur u zhvillua kjo tryezë, Komisioni Parlamentar i Ligjeve mori në diskutim draftin e plotë të ndryshimeve kushtetuese për t'ja kaluar më pas Kuvendit për miratim.

Për të gjitha arsyet/qëllimet e renditura më sipër, INFOÇIP u siguruar që të gjithë aktorët kryesorë të sistemit të ishin të pranishëm dhe të ofronin opinionet, kritikat, vlerësimet dhe rekomandimet e tyre mbi këtë vlerësim të parë tematik me mbulim kombëtar për gjykatat adminitrative që nga hyrja në fuqi e ligjit 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

Nga trupa gjyqësore, në tryezë morën pjesë të gjithë krerët e gjykatave administative të vendit, në të treja shkallët e saj dhe konkretisht Z. Xhezair Zaganjori, Kryetar i Gjykatës së Lartë dhe kryetar i Kolegjit Administrativ në këtë Gjykatë, njëkohësisht kryetar i Konferencës Gjyqësore të RSH. Të pranishëm ishin gjithashtu edhe z. Kastriot Selita, kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit, e vetmja në Shqipëri, z.Eriol Roshi, kryetari i GjA të Tiranës; z.Astrit Shema, kryetari i GJA Vlorë; znj. Valbona Duraj, kryetarja e GJA Shkodër; z.Genci Sinjari, kryetari i GJA Durrës; z. Sokol Ibi, kryetari i GJA Korçë dhe z. Ramiz Lala, kryetari i GJA Gjirokastër.



Në tryezë morën pjesë edhe përfaqësues nga sistemi i zakonshëm i gjykatave si z.Fatri Islamaj, *kryetar i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë*, Z. Ilir Mustafaj, *gjyqtar i Gjykatës së Tiranës, ish-anëtar i KLD*, znj. Manjola Bejleri, *gjyqtare e Gjykatës së Tiranës dhe ish-kryetare e SHKGJ* si dhe përfaqësue të tjerë nga Gjykata Kushtetuese (znj. Valbona Pajo), nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, pedagogë universitarë të së drejtës publike-administrative, etj.

Nga Ministria e Drejtësisë i pranishëm në këtë tryzë të rëndësishme ishte ministri i drejtësisë, Z. Ylli Manjani. Ai në fjalën e tij përshëndetëse kreditoi maksimalisht gjetjet dhe kërkoi zgjerimin e programit të vlerësimeve të pavaruara tematike të ndërmarrë nga INFOÇIP dhe OSFA. *"Vlerësimi im është*

*maksimal për nismën e INFOÇIP. Vlerësimi të tilla profesionale për punën e gjykatave dhe institucioneve të drejtësisë duhet të jenë të vazhdueshme".*

Po ashtu në këtë tryezë orën pjesë edhe përfaqësuesit më të lartë të organizatave kryesore ndërkombëtare dhe donatore në Shqipëri, që ofrojnë asistencën e tyre në fushën e drejtësisë, konkretisht z. Andi Dobrushi, drejtor i OSFA (Fondacioni SOROS), z. Marcus Johnson, drejtor i USAID në Shqipëri, Z. Jan Rudolph, Shef i Seksionit Politik të Delegacionit të BE, Tiranë, z. Ranier DeVille, shef i Misionit EURALIUS, Z. Olsi Dekovi, shefi i zyrës së KiE në Shqipëri, Z. Olsi Dekovi, etj. Të tjerë përfaqësues institucionalë që morën pjesë në punimet e kësaj tryeze kombëtare ishin edhe Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtës së Informimit, Z. Besnik Dervishi.



Në fjalën e tij, drejtori i Fondacionit SOROS u shpreh ndër të tjera se: "Është e rendësishme që të ndodhë një përkthim i këtyre shqetësimeve në një dokument konkret, dhe të këtë një gjurmë, dhe mos të ngelet vetëm për konsum të brendshëm brenda nesh... mendoj që është shumë e rëndësishme ndjekja konsistente e problematikës që del... Në këtë pikë, si përsa i takon INFOCIP, si përsa i përket Fondacionit, por edhe në bashkëpunim me gjykata, mendoj se të gjithë bashkë mund ta vemë në lëvizje mekanizmin, për të tërhequr vëmendjen ndaj këtyre problemeve. Mbështetja jonë do të vazhdojë të jetë siç ka qenë dhe do vazhdojë të jetë e qëndrueshmë dhe e fortë"

Vlerësim maksimal për metodologjinë dhe rezultatet e studimit shprehën edhe përfaqësuesi i USAID në Shqipëri, z. Marcus Johnson "*Ajo se cfare do të bëjmë me këtë vlerësim të INFOCIP, eshte të shohim se si mund ta përdorim në mënyrë që të bëjmë programin tonë dhe më të mire... ne shohim*

*cdo informacion dhe oportunitet si ky që prezantoi INFOÇIP si aset për të përmirësuar atë që ne po bëjmë këtu më programin tonë*", u shpreh ai.

Edhe përfaqësuesi i BE në këtë Tryezë, z. Jan Rudolph, Shef i Seksionit Politik të Delegacionit të BE në Tiranë, vlerësoi lart studimin duke kredituar në mënyrë të posaçme prodhimin e statistikave të besueshme të cilat hedhir dritë mbi problematikën brenda sistemit. "*Në raportin e fundit vjetor per Shqiperinë, dy nga katër rekomandimet tona kanë të bejnë pikerisht me efikasitetin në drejtësi. Nga vlërsimet tona, edhe mundesia që ka sistemi që të japë të dhëna statistikore të besueshme, mbetet një shqetësim. Jam shumë i sigurt që gjetjet e ketij raporti do të japin edhe me shumë ide per profesionistët*", u shpreh Rudolph.

Pas përshëndetjeve të të ftuarve kryesorë, drejtori i INFOÇIP, Gerti Shella vijoi me prerzantimin e detajuar të gjetjeve të studimit. Gjatë prezantimit, ai u shpreh se "Qëllimi ynë i përbashkët është të gjejmë mjetet e domososhme që shqyrtimi gjyqësor të rikthehet në afatet që cakton ligji. Sot ne mund të hapim një diskutim se si mund të jete më e mire praktika, por edhe ligji, ne kuadër të amendimeve të mundshme".

Rezultatet e prezantuar nga INFOÇIP, u pranuan plotësisht nga të pranishmit. Ato u konsideruan "objektive, të paanshme dhe profesionale", duke shënuar kështu një moment shumë të rëndësishëm të pranimit të rezultateve të monitorimit nga subjektet e tij të drejtpërdrejta.

Kryetari i Gjykatës së Lartë, njëkohësisht edhe kryetar i seksionit administrativ në GJL, si dhe kryetar i Konferencës Gjyqësore Kombëtare u shpreh: d*uke qenë edhe vetë anëtar i KLD-së, kam vënë re se përsa i perket dorezimit te vendimeve ne shkallen e pare dhe ne apel, ato tani dorëzohen me shpejt",* u shpreh Z. Zaganjori duke falenderuar INFOCIP për punën e bërë në këtë drejtim. Po ashtu, edhe kryetari i GJA të Apelit, Z. Kastriot Selita, kreditoi maksimalisht objektivitetin e gjetjeve "Unë gjej rastin të shpreh nje falenderim të vecantë per faktin dhe saktësinë e informacionit që juve keni nxjerrë dhe keni arritur me shumë sukses të përpunoni gjatë gjithë veprimtarise tuaj. Po ashtu, edhe kryetari I GJA të Tirtanës, Z. Erjol Roshi falenderoi INFOÇIP për objektivitetin e lartë të vlerësimit dhe theksoi se që pas monitorimit të fundit, ai dhe stafi i gjykatës I kishin kushtuar rëndësi maksimale dorëzimit në afat të vendimeve. *"rezultati pozitiv i paraqitur nga INFOCIP për ne në këtë drejtim ishte i pritshëm, dhe për këtë jam shumë i kënaqur*", u shpreh ai. Edhe kryetarja e GJA Shkodër, Znj. Valbona Duraj ka pranuar plotësisht

gjetjet dhe ka ofruar më pas edhe një seri segjerimesh me vlerë në drejtim të përmirësimit të mëtejshmë të treguesve te efikasistetit të GJA.

E gjitha pjesë e dytë e Tryezës kishte në fakt për synim të mblidhte dhe të përpunonte sa më shumë rekomandime për përmirësimin e treguesve. Ky set rekomandimesh që u hartua në sesionin e dytë të tryezës përfaqëson një objektiv tjetër të plotësuar. Ato janë kontribut direkt i aktorëve kryesorë të interesit dhe produkt i një diskutimi të hapur dhe të bazuar mbi evidence të pranuara nga të gjithë palët paraprakisht.

Për shkak të rëndësisë së këtyre rekomandimeve, stafi i INFOCIP i kushtoi që në fillim vëmendje të posaçme dokumentimit të plotë të eventit. Në periudhën post-event që pasoi, të gjitha fjalimet dhe diskutimet u veçuan dhe u transkriptuan. Çdo rekomandim, sugjerim apo koment u ekstraktua me kujdes nga meterialet e regjistruara dhe u organizua në një kapitull të posaçëm, i cili i është shtuar botimit paraprak që u prezantua fillimisht në tryezë. Në formën e tij përfundimtare, botimi përmban kapitullin e gjetjeve plotësisht të konsoliduar (gjetjet plotësisht të pranuara dhe pa asnjë reklamim për rezultatin e monitorimit) si dhe një kapitull shtesë me materialet e përpunuara nga tryeza me aktorët kryesorë të sistemit të drejtësisë administrative.

Fjalët pëshëndetëse dhe mesazhet më të rëndësishme të dhëna nga aktorët kryesorë institucionale janë vlerësuar më shumë kujdes. Për t'i dhënë gjithë hapësirën e nevojshme diseminimit të këtij produkti, të gjitha materialet e tryezës së nivelit të lartë janë përpunuar dhe më pas janë ngarkuar online në faqen zyrtarë të INFOCIP (www.infocip.org) si dhe në kanalin e INFOÇIP në YuoTube. Kjo qasje është konsideruar e domosdoshme për të rritur aksesin në rekomandimet e kësaj tryeze të rëndësishme, si një pikë referimi për ngritjen dhe zgjidhjen në të ardhmen të problematikës së konstatuar.

INFOÇIP, në vijim të traditës së mirë të krijuar në këto vite, ka për synim ndjekjen e procesit dhe shtyrjen përpara të rekomandimeve të dhëna nga protagonisët kryesorë të sistemit të drejtësisë administrative në RSH. Ndër pritshmëritë kryesore në muajt në vijim janë amendimi i ligjit 49/2012, rivlerësimi i juridiksioneve tokësore dhe lëndore të GJA, plotësimi i trupës gjyqësore me gjyqtarët që mungojnë, optimizimi i praktikës gjyqësore administrative, plotësimi me burimet e domosdoshme njerëzore (gjyqtarë dhe ndihmës) si dhe përmirësimin e infrastrukturës së Gjykatave Administrative.

# REKOMANDIMET NGA PERFAQESUESIT E GJYKATAVE ADMINISTRATIVE



## XHEZAIR ZAGANJORI, KRYETAR I GJYKATES SE LARTE DHE KOLEGJIT ADMINISTRATIV

- **Gjykimi i cështjeve në gjykatën e lartë të diferencohet sipas llojit të çështjeve. Çështjet qe lidhen me pushimin e padrejtë nga puna duhet të trajtohen me përparësi dhe të gjykohen shpejt, pavarësisht backlog-ut.** *Aktualisht në GJL është vendosur rregull i brendshëm që çështjet duhet te gjykohen ne rradhe te pare me numer rregjistrimi, pra me rradhe. Përjashtim bëjnë konfliktet e punës dhe pensionet.*
- **Numri i gjykatësve është ipakët në sistemin e drejtësisë administrative dhe ky numër duhet të rritët në përpjestim me rritjen që kanë përsuar numri i cështjeve që mbërrijnë në dyert e gjykatave.** *Në gjykatën e lartë duhet te jene 19 gjyqtarë, por ka faktikisht vetëm 16 (deri në 15 qershor 2016).*
- **Ngarkesa eshte jashtezakonisht e madhe dhe sa vjen e shtohet prandaj kerkohet patjeter te ketë filter duke iu referuar përvojës më të mirë në sistemin kontinental** (të vendeve si Daminarka, Gjermania). *Duhen përzgjedhur për gjykim në shkallë të lartë vetëm ato çështjet që kanë nevojë për unifikim. Janë indentifikuar qartesisht rreth 80 probleme nga GJL qe kane nevoj per unifikim, si dhe nevojen per ndryshime ligjore, kryesisht ne kodet e procedures po dhe ne ligjet e tjera.*
- **Të konsiderohet mundësia per adoptimin e mënyrave alternative për zgjidhjen me albitrim ose me ndermjetesim te konflikteve administrative.** *Këto institute apo mekanizma (alternative dispute resolution) janë inekzistente sot për sot në Shqiperi.*
- **Kryetarëve të gjykatave duhet t'ju jepen më shumë kopetenca për të administruar situatën efektivisht dhe për të kërkuar ata llogari për performancën e cdo gjyqtari.** *Nëse nuk i përdor kompencat për të përmbushur detyrimet ai më pas të largohet nga puna duke u zëvendësuar me një tjetër.*
- **Sugjerohet të krijohet senate, sipas modelit të disa vendeve, me përbërje 3-5 gjyqtar te cilet ndihmojne kryetarin në menaxhimin e çështjeve nëpër gjykatat administrative.**

## KASTRIOT SELITA, KRYETARI I GJYKATES ADMINISTRATIVE TE APELIT



- **Rekomandohet që sërish numri i gjyqtareve në Gjykatën Administrative të Apelit duhet të rishikohet drejt një numri edhe më të madh gjyqtaresh.** *Edhe pse* në muajin Mars të v*itit 2016 trupa gjyqsore u shtua me 6 gjyqtare të tjere, numri i cështjeve të ardhura dikton sërish rritje të trupës gjyqësore per të patur  nje shkalle me të lartë të evadimit të ceshtjeve nga gjykata.*



## ERIOL ROSHI, KRYETARI I GJYKATES ADMINISTRATIVE TE SHKALLES SE PARE, TIRANE

- **Kompetenca lëndore e GJA dhe aspekte procedurale** të lidhura më të duhen rivlerësuar në drejtim të ngushtimit të mëtejshëm**; duhet** t**ë merren masa** q**ë ligji të rikthehet** në **frymën e tij.** Është vënë re një prirje që nga viti 2013 kur filloi funksionimi GJA që zgjerohet gradualisht rrethi i kompetencës *se saj lëndore. Në frymën e tij, ligji parasheh që i paditur duhet të jetë organi i administratës publike por sot po shënohen raste kur të paditur janë qytetarët. Mjafton një padi ndaj tij që të fillojnë të rrjedhin të gjitha pasojat që parashikon ligji, si psh. barra e proves. Një situatë tipike për të ilustruar ketë rrethanë të përmbysur janë rastet ku kundërshtohen aktet e marrjes së tokës në pronësi. Janë pafund gjykimet që iniciohen nga prefektët e qarqeve për të kundërshtuar aktet e marrjes se tokës në pronësi dhe gjykatat administrative në vend që të gjykojë vlefshmërinë e një akti administrativ, detyrohen* të shohin ka apo nuk ka mbive*ndosje midis pronave të qytetarëve të ndryshem. Ky lloj shqyrtimi gjyqësor kërkon kryerjen e një inspektimi dhe në gjykimet me inspektim nuk mund të respektohen dot afatet 30-ditore.*Fakt është se nuk *ka patur asnjë rast të përfundimit brenda 30 ditësh të një gjykim themeli kur kërkohën që të marren prova përmes ekspertëve.*
- **Procedura e gjykimit mund dhe duhet gjithashtu të përmirësohet përmes diferencimit sipas llojit të çështjeve.** *Sot GJA gjykojnë me të njëjtën procedurë si kundravajtjet administrative (ku më tipiket jane ato që parashikohen në Kodin Rrugor) ashtu edhe  njoftimin* për vlerësimin e detyrimeve tatimore, që mund

të kapin vlerën e milionave eurove. Kjo krijon vështirësi të mëdha edhe në respektimin e afatit të gjykimi.

- **Rekomandohet të unifikohet kriteri i vlerës në përcaktimin e trupës gjyqësore.***Ndodhemi në situatën paradoksale ku një njoftim i detyrimit tatimor me vlerë miliona euro gjykohet nga nje gjyqtar i vetëm (sipas përcaktimit në ligj), ndërkohë që një kontratë administrative, fjala bie, mos-dorezimi në kohë i mobiljeve të porositura nga një institucion me vlera të pa përfillshme, gjykohet nga 3 gjyqtarë.*
- **Të lejohet kohë procedurale ekstra në dispozicion të gjyqtarëve të GJA për të përmbyllur arsyetimin e vendimit.** *Afati i dorëzimit 7 ditë eshtë shumë i shkurtër nga afati që përcakton Kodi i Procedurës Civile...*
- **Të rivlerësohet përmbajtja e dispozitës përkatëse për afatin e dorëzimit të dosjes.** Qëllimi i ligjvenësit eshtë që vendimi të shpallet i arsyetuar dhe ligji thekson se dosja dorëzohet *brenda 7 ditëve në kryesekretari. Gjyqtarët te GJA të Shkalles se Pare, Tiranë por jam i sigurt edhe ata në rrethe vendimojnë 20 çështje në jave. Pra, është njerezisht e pamundur që të arsyetohen keto çështje.*
- **Të rivlërësohet organika e gjykatave të shkallëve të para, përfshirë trupa gjyqësore dhe admisnistrata përmes një studimi të mirëfilltë.**
- *Një çështje që i prek të gjitha gjykatat njësoj janë organikat e gjykatave të cilat nuk janë studiuar sa duhet. Kjo u pa në Gjykatën* Administrative *të Apelit fillimisht. Sot po e konstatojme dhe në GJA të shkallës së parë Tiranë, ku për shkak të largimit të disa gjyqtarëve për shkaqe njerzore dhe të nje vendi vakant që eshtë krijuar për shkak të largimit të nje gjyqtari, sot gjukata administrative e rrethit Tiranë gjykon me 12 gjyqtar duke përfshire dhe kryetarin e gjykatës. Behet fjale për nje gjykatë që mbulon 2 qarqe nga të cilat një qark eshtë Tirana (qarku me i madh i vendit). Pesë 5 rrethe administrative ku 4 janë rrethe gjyqësore me një popullsi mbi 1 milion banore gjykohen vetëm nga 12 gjyqtare.*
- **Rekomandohet monitorim dhe marrja e masave për të garantuar cilësine dhe jo vetëm shpejtësinë e vendimeve administrative.** Për shumë vendime qe arsyetohen, duhet ndjekur jo vetëm nje ligj i caktuar po edhe aktet ligjore që kanë ndryshuar pafundësisht , VKM , udhezime, rregullore, Nje cilesi e dobet do të sjellë si pasojë që ceshtjet të kthehen për rigjykim dhe prapë do të fillojë nga e para dhënia e drejtësisë.
- **Sistemet elektronike ku realizohen njoftimet dhe kryhet**

**edhe transparenca e punës së gjykatave duhet të jenë në përdorim të vetë gjykatave.** *Aktualisht sot vetëm gjykata admisnistrative e Apelit ka faqen e saj në internet, ndërkohë GJA të shkallëve të para marrin/ofrojnë shërbimin përmes një portal të centralizuar në MD, i cila ka mjaft limitime.Zyra administrative e buxhetit gjyqësor në komunikimet zyrtare me GJA Tirane, nuk ka pranuar hapjen e nje faqe zyrtare. Kjo sjell për pasojë që të kritikohemi dhe me të drejtë nga mediat përgjithesisht për mugesë transparence.*



## VALBONA DURAJ, KRYETARJA E GJYKATES ADMINISTRATIVE TE SHKALLES SE PARE, SHKODER

- **Plotësimi me gjyqtarë i trupës gjyqësore në gjykatat administrative të rretheve është domosdoshmëri.** *Aktualisht GJA e shkallës së parë Shkodër, Gjirokastër dhe Korcë janë duke punuar me nga 2 gjyqtarë që prej krijimit të tyre në vend të 4 që përcakton ligji.*
- **Nëse vetë kriteret ligjore të vendosura (vjetërsia në detyrë, formimi professional) janë bërë pengesë për plotësimin e trupës gjyqësore, atëherë ato duhet të amendohen sa** më parë përmes një procedure legjislative. Përmes një ndryshimi ligjor, kriteri i vjetërsisë në punë të ulet nga 7 në 5 vjet për lehtësuar në këtë mënyrë procesin e plotësimit të trupës gjyqësore të GJA. *Sa më shpejt të abrogohen këto kritere përmes amendimeve ligjore dhe nënligjore, aq më shpejt plotësohet vakumi i krijuar në plotësimin me gjyqtarë të rinjë të trupës së GJA.*
- **Të konsiderohen ndërhyrjet ligjore për të lejuar studentët e Magjistraturës që të përjashtohen nga testimi profesional për shkak të kompleksitetit që përfaqëson e drejta administrative duke lënë vetëm kriterin e vjetërsisë në punë.**
- **Rekomandohet që viti i 3 i shkolles se magjistraturës i cili tani është një vit praktike, të kryehet n**ë Gjykatat **Administrative për magjistratët**. *Sugjerohet amendim i ligjit për të lejuar adoptimin e një praktiketë tillë edhe për GJA.*
- **Numri i gjyqtarëve për gjykatën administrative Shkodër sugjerohet duhet të jetë të paktën 6.** *Vetëm në periudhën Janar-Maj 2015, në këtë gjykatë kanë ardhur për gjykim 600 çështje dhe janë dhënë vendim për 450 prej tyre, pa llogaritur ato që tashmë janë të cështje të*

*mbartura prej tre vjetësh dhe që gjithashtu gjykohen paralelisht. Ky opinion është hedhur në KLD dhe është paraqitur dhe tek Ministri i Drëjtësise por akoma nuk është gjetur nje zgjidhje. Aktualisht magjistratët caktohen në Gjykatën e Tiranës, porn ë asnjë rast nuk dërgohen të bejnë praktiken në GJA për shkak të përcaktimeve aktuale ligjore.*

- **Nëse kjo është për momentin e pamundur, duhet të këtë një rritje të numrit të ndihmësave ligjorë në shkallë të parë sidomos.** *Ndihmësi ligjor është parapërgatit cështjen për gjykim dhe shtimin e numrit të tyre mund të ishte një zgjidhje e ndërmjetme për të rritur eficiencën e gjykimit administrativ.*
- **Edhe kriteri i caktimi i të njëjtit numër gjyqtarësh, konkretisht katër për çdo GJA të shkallës së parë duhet të rishikohet.** *Gjykatat me ngarkesë më të lartë duhet të kënë një numër më të lartë gjyqtarësh krahasuar me ato që përballojnë ngarkesë më të ulët. Mentaliteti i popullatës në zona të ndryshem dhe niveli i respektimit të ligjit prej saj janë faktorë që duhen mbajtur gjithashtu parasysh në këtë proces të rishpërndarjes së trupës gjyqësore administrative (psh GJA Shkodër krahasuar me GJA Korçë, edhe pse kanë numër të njëjtë gjyqtarësh, kanë flukse krejt të ndryshme sa i takon çështjeve që ankimojnë në GJA respektive).*
- **Aksesi në drejtësinë administrative duhet të përmirësohet, duke konsideruar shtimin e numrit të gjykatave të shkallës së parë në territorin e vendit.** *Aktualisht në Shqipëri funksionojnë 6 (gjashtë) gjykata administrative të shkallës së parë në: Durrës, Gjirokastër, Korçë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë dhe nëj Gjykatë Administrative Apeli, me seli në Tiranë. Neës merret si shembull Gjykata Administrative Shkodër, ajo ka juridiksion tokësor në tre qarqe të veriut, konkretisht Shkodër, Kukës dhe Lezhe. Për të paraqitur një ankese në GJA Shkodër, një qytetari nga Kukësi do t'i duhet të udhëtojë deri në Shkodër, dhe mandej të udhëtojë sërish bashke më palën ndaj të cilës është depozituar ankim gjyqësor për të njdekur procesin. Rekomandohet shtimi deri në 10 i numrit të GJA të shkallës së parë në RSH, duke parë edhe shtimin e volumit të ankesave në këto vite të para të funksionimit të tyre. Një studim i hollësishëm mbi ngarkesën specifike duhet të ndërmerret paraprakisht, duke konsideruar edhe ndarjen e re administrative territoriale të RSH, e cila u aktivizua de jure dhe de facto pas zgjedhjeve të 21 Qershorit 2015.*
- **Marxhi i vendimeve të paankimueshme të dhëna nga GJA duhet të vijë në rritje.** *Kjo diktohet nga vetë natyra e gjykimit administrative por edhe nga përvoja e vendeve të tjera me drejtësi administra-*

*tive të zhvilluar. Nëse duhet të kemi eficiencë te gjykimeve administrative duhet të rishikohet neni 45 i ligjit 49/2012* për vendimet e pa-ankimueshe.

- **Të forcohet roli i Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji, dhe jo** të kthehet në një gjykata ankimi e nivelit të tretë. *Në GJL vijojnë të gjykohen çështje që kanë të bëjnë me marrdhëniet e sigurimeve shoqërore qe nga viti 2010 ndërkohë që njerëzit po ndërrojnë jetë pa marrë as vendimin e as pensionin. Po ashtu edhe mardhëniet e punës gjykohen me vonesa ekstreme. Aktualisht ato po kalojnë edhe harkun kohot të një rotacioni pushteti (4 vjet), duke vënë në pikëpyetje kështu jo vetëm eficencën, por edhe besueshmerinë e sistemit të gjykatave administrative.*
- **Rekomandohet eleminimi i hallkave të ndërmjetme të ankimit administrativ.** *Sot, çështjet administrative nuk ankimohen direkt në gjykatën kompetente përveç atyre që kanë të bëjnë me Kodin Rrugor. Ato njekin rrugën e ankimit në nivelet eprore të administratës, të cilat po të vlerësohen në %, rezultojnë hallka të tepërta e të padobishme. Vetëm 5% të rasteve kanë marrë nje zgjidhje në ankimimin administrativ në hierarkinë vertikal të Administratës Publike, ndërkohë që kjo procedurë konsumon rreth 1 vit kohë për t'u ezauruar si hallkë ankimimi, para se ankimi të mbërrije në GJA. Nëse shthet edhe koha e pritjes në gjykatë, besueshmëria tek kjo lloj drejtësi vjen e ulet, e po ashtu edhe efektiviteti. Rekomandohet zgjidhja e mosmarrveshjeve me natyrë administrative direkt në Gjykatën Administrative.*



**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

**Qëndra për Çështje të Informimit Publik**

Vlerësimi i afateve ligjore në shqyrtimin gjyqësor administrativ dhe dorëzimin e vendimeve : monitorimi tematik kombëtar : viti 2015 / Qëndra për Çështje të Informimit Publik ; drejt. studimi Gerti Shella. – Tiranë : INFOCIP, 2016

80 faqe. ; 17.6 cm x 25 cm.

**ISBN 978-9928-4372-0-4**

ISBN 978-9928-4372-0-4
9 789928 437204



"Vlerësimi im është maksimal për nismën e INFOÇIP. Vlerësimi të tilla profesionale për punën e gjykatave dhe institucioneve të drejtësisë, me konkluzione absolutisht shkencore, duhet të jenë të vazhdueshme. Kjo nismë ja vlen dhe duhet të thellohet më tej"…

**YLLI MANJANI,** *Ministër i Drejtësisë*



"Në përpjekjen për të bërë Reformë të madhe po harrojmë që me disa gjëra të vogla, nëse rregullohen, mund të këmi një përmirësim shumë të ndjeshëm të sistemit të drejtësisë, në rastin konkret gjykatave administrative".
Për ne ka qenë shumë e rëndësishme si Fondacion që këto nisma t'i mbështesim, për me tepër një monitorim si ky qe kryehet nga vetë ne shqiptarët, dhe që krijon një proces dialogimi objektiv...Mendoj se të gjithë bashkë mund ta vemë në lëvizje mekanizmin, për të tërhequr vëmendjen ndaj këtyre problemeve. Mbështetja jonë do të vazhdojë të jetë e qëndrueshmë dhe e fortë"

**ANDI DOBRUSHI,** *Drejtor i Fondacionit SOROS*

"Ajo se cfare do të bëjmë me këtë vlerësim të INFOCIP, eshte të shohim se si mund ta përdorim në mënyrë që të bëjmë programin tonë dhe më të mire…ne shohim cdo informacion dhe oportunitet si ky si aset për të përmirësuar atë që ne po bëjmë".



**MARCUS JOHNSON**
*Shef i Misionit të USAID në Shqipëri*



"Në raportin e fundit vjetor per Shqiperinë, dy nga katër rekomandimet tona kanë të bejnë pikerisht me efikasitetin në drejtësi. Nga vlërsimet tona, edhe mundesia që ka sistemi që të japë të dhëna statistikore të besueshme, mbetet një shqetësim… Jam shumë i sigurt që gjetjet e ketij raporti do të japin edhe me shumë ide per profesionistët."

**JAN RUDOLPH,** *Shef i Seksionit Politik të Delegacionit të BE në Tiranë*

ISBN 978-9928-4372-0-4